



ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Sektori për Inspektim

Ref. Nr. 001

DATA / DATUM / DATE	08.01.2026
NR / BR / NO	01/2026
PËR / ZA / TO	z. Agim Aliu - Kryetar i Komunës
CC	z. Lulzim Aliu – Nënkyetar i Komunës
PËRMES / PREKO / THROUGH	Drejt përdrejt
NGA / OD / FROM	Feriz Hyseni – Udhëheqës i Sektorit për Inspektim
LËNDA / SUBJECT / SUBJEKAT	Plani vjetor i punës për vitin 2026 i Sektorit për Inspektim



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026 I SEKTORIT PËR INSPEKTIM

Përmbajtja:

Baza Ligjore	4
Sektori për Inspektime	4
Aktivitetet e Sektorit për Inspektime.....	5
Organizimi dhe Plani Inspektues.....	5
Prioritetet e punës.....	5
Struktura e Sektorit për Inspektime.....	6
Inspektorati Komunal i Ndërtimit	6
Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Komunal të ndërtimit gjatë kontrollave inspektuese në teren	6
Objektivat e Inspektoratit Komunal të Ndërtimit për vitin 2026.....	7
Realizimi i Objektivave.....	7
Plani vjetor i punës i Inspektoratit të Ndërtimit për vitin 2026	8
Inspektorati Komunal i Shërbimeve Publike.....	12
Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit Komunal të Shërbimeve Publike, gjatë kontrollave inspektuese në teren.....	12
Objektivat e Inspektoratit Komunal të Shërbimeve Publike për vitin 2026.....	13
Realizimi i Objektivave.....	13
Plani vjetor i punës i Inspektoratit Komunal të Shërbimeve Publike për vitin 2026	15
Inspektorati Komunal i Tregut	20
Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Komunal të Tregut gjatë kontrolleve inspektuese në teren	20
Objektivat e Inspektoratit Komunal të Tregut për vitin 2026	20
Realizimi i Objektivave.....	21
Plani vjetor i punës i Inspektoratit Komunal të Tregut për vitin 2026	22
Inspektorati Komunal i Mbrojtjes së Mjedisit.....	26
Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit gjatë kontrollave inspektuese në teren.....	26
Objektivat e Inspektoratit Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2026	26
Realizimi i Objektivave.....	27
Plani vjetor i punës i Inspektoratit Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2026.....	28
Inspektorati Komunal i Komunikacionit.....	34
Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit Komunal të Komunikacionit, gjatë kontrolleve inspektuese në teren.....	34
Objektivat e Inspektoratit Komunal të Komunikacionit për vitin 2026	34

Realizimi i Objektivave.....	34
Plani vjetor i punës i Inspektoratit Komunal të Komunikacionit për vitin 2026.....	35
Totali i numrit të inspektimeve i Sektorit për Inspektime në Komunën e Ferizajt.....	39
PËRFUNDIM.....	40

Baza Ligjore

Plani vjetor i Sektorit për Inspektime në Komunën e Ferizajt bazohet në dispozitat që dalin nga Ligji nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale; Ligji Nr.08/L-067 Për Inspektimet; Ligji nr.04/L-175 Për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimet Hapësinore dhe Ndërtimit; Ligji për Inspektoratin e Tregut nr.03/L-181; Ligjin nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-175; Rregullores 01.Nr.114 Për Rregullin dhe Shërbimet Komunale në Komunën e Ferizajt; Ligji nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor; Ligji nr. 08/L-186 Për Rregullat e Trafikut Rrugor; Ligji nr.08/L-275 Për Rrugët dhe Statutin e Komunës së Ferizajt 01.Nr.50.

Sektori për Inspektime

Sektori i Inspektimit përbën mekanizmin kryesor të kontrollit dhe garantimit të ligjshmërisë për Komunën e Ferizajt.

-Çdo inspektor është i obliguar të inspektojë në fushën e përgjegjësive për të cilat është i emëruar si dhe për inspektimet e bëra harton procesverbal të inspektimit dhe merr të gjitha masat konform ligjeve bazuar në situatën e krijuar.

-Inspektorët janë të pavarur dhe përgjegjës për punën e tyre deri në përmbylljen e plotë të lëndëve duke zbatuar ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret në fuqi.

-Udhëheqësi i Sektorit për Inspektime mund të ngarkojë me detyra shtesë inspektorët në mungesë të inspektorit adekuat.

Sektori për Inspektime do të jetë përgjegjës për performancën e detyrave si në vijim:

-Mbikëqyrjen dhe aplikimin e Ligjeve dhe akteve të tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut, mbrojtjen e mjedisit, komunikacionit si dhe në fushën e shërbimeve publike etj.

-Të zbatojë inspektimin në lëminë e ndërtimit dhe rindërtimit për të siguruar pajtueshmëri me rregullat e ndërtimit dhe planifikimit, në veçanti ndërtimet pa leje.

-Implementimin e praktikave të Inspektoratit të Tregut duke përfshirë shitjen ilegale të mallrave, ushtrimin e biznesit në pajtueshmëri me orarin e punës, luftimin e informalitetit, si dhe mbrojtjen e konsumatorit etj.

-Të sigurojë standarde të larta në lëminë e mbrojtjes së ambientit, monitorimi i ndotjes nga djegiet e thëngjillit, plastikës si dhe sendeve tjera të cilat ndotin ambientin e të cilat nuk lejohen të digjen, inspektimi i hapësirave publike afër ndërtimeve lidhur me ndotjen e rrugëve, si dhe ndikimin e tyre në ndotjen e mjedisit.

- Qëllimi i Inspektorit të Komunikacionit është kujdesi ndaj zbatimit të ligjit, ofrimi i shërbimeve sa më të mira për qytetarët nga njësia e komunikacionit dhe transportit, krijimi i një ambienti të shëndoshë dhe ngritja e këtyre shërbimeve në një shkallë më të mirë dhe cilësore.

-Të sigurojë inspektimin në lëminë e Shërbimeve Publike, me theks të veçantë në monitorimin e hapësirave publike, shesheve, parqeve, rrugëve, trotuareve, rrjetet e ujërave të zeza dhe atmosferike, ujësjellësit dhe instalimet të tjera.

-Ekzekuton vendime, përcjell, evidenton dhe ndërmerr masa ligjore ndaj subjekteve-operatorëve që kryejnë veprimtari jo ligjore nga kompetencat e këtij sektori.

-Të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë e tjera Komunale.

Aktivitetet e Sektorit për Inspektime

Në realizimin e objektivave të inspektimit në Sektorin për Inspektime, parashihen këto aktivitete:

-Planifikimi i inspektimeve (përfshirë hartimin e planit vjetor dhe mujor të inspektimeve; përcaktimin e prioritetëve të riskut).

-Inspektimi i veprimtarive-subjekteve afariste, hapësirave publike, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e konsumatorit, kontrolli i transportit publik.

-Njoftime në parashitja zyrtare.

-Trajtimi i rasteve AD-HOC.

-Përpilimi i procesverbaleve, nxjerrja e vendimeve dhe akteve të tjera dhe ekzekutimi i tyre, shqiptimi i vërejtjeve dhe urdhrave për përmirësim, vendosjen e gjobave administrative, vendimet për ndalim të përkohshëm ose mbyllje, përcjellje të rasteve në organet kompetente.

-Paraqitja e shkeljeve kundërvajtëse dhe kallëzime penale.

Organizimi dhe Plani Inspektues

-Inspektimi do të realizohet në tërësi duke mbuluar territorin e Komunës së Ferizajt.

-Sektori për Inspektime do të organizohet në grupe inspektuese të kombinuara.

-Angazhimi i një ekipi inspektues sipas nevojës (pas orarit të rregullt të punës dhe vikendeve).

Prioritetet e punës

Sektori për Inspektime në realizimin e planit të punës, bazohet në trajtimin e çështjeve sipas rëndësisë. Andaj duke u bazuar në këtë, në kryerjen e detyrave dhe realizimin e objektivave Sektori për Inspektime bazohet në këto lloje të inspektimeve:

-Inspektim i planifikuar;

-Inspektim i paplanifikuar;

-Inspektim sipas parashitjes;

-Ri-inspektim dhe

-Inspektim i përbashkët.

Struktura e Sektorit për Inspektime

Sektori për Inspektime përbëhet nga këto njësi:

- Inspektorati Komunal i Ndërtimit
- Inspektorati Komunal i Tregut
- Inspektorati Komunal i Mbrojtjes së Mjedisit
- Inspektorati Komunal i Komunikacionit
- Inspektorati Komunal i Shërbimeve Publike

Inspektorati Komunal i Ndërtimit

Inspektorati komunal i ndërtimit vepron në bazë të autorizimeve dhe kompetencave ligjore nga Ligji Nr.04/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligji Nr.08/L-067 Për Inspektime; Ligji 04/L-175 Për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit hapësinor dhe Ndërtimit; Ligji Nr.05/L-087 Për Kundërvajtje; Ligjit Nr.04/L-110 Për Ndërtim; Udhëzimit Administrativ 05/2017 Për Mbikëqyrjen Inspektuese dhe Procedurën për Lëshimin e Certifikatës së Përdorimit dhe Udhëzimit Administrativ 20/2013 Për Mënyrën, Procedurën dhe Shumën e Gjobave ndaj Pjesëmarrësve në Ndërtim.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Komunal të ndërtimit gjatë kontrollave inspektuese në teren

- Bën kërkesë për Miratimin e Inspektimit dhe bën njoftimin për Inspektim për palët që i nënshtrohen inspektimit.
- Inspektori i Ndërtimtarisë bën mbikëqyrjen në zbatimin e ligjit dhe rregulloreve tjera që kanë të bëjnë me ndërtimet (projektet e ndërtimit, planet, etj.).
- Mbikëqyrë standardet e ndërtimit dhe të produkteve ndërtimore si dhe konstruksionet që vihen në përdorim gjatë ndërtimit.
- Kontrollon dokumentacionin tekniko-investues, kryerjen e punëve ndërtimore, se a kryhen këto punë në përputhje me dokumentacionin teknik-investues në bazë të cilit është dhënë leja e ndërtimit.
- Inspekton librat e punimeve, kujdeset për kontrollin e materialit ndërtimor, instalimet ndërtimore dhe kualitetet teknike.
- Prania e të metave gjatë punimeve apo mospërmbajtja e rregullave të ndërtimit e obligon inspektorin e ndërtimtarisë që ta urdhërojë kryesin e punimeve që t'i evitojë të metat e theksuara duke i ndaluar punimet që të vazhdojnë më tej.
- Përcjellë secilin rast veç e veç duke përgatitur lëndë të posaçme që nga fillimi i procedurës administrative me përpilimin e procesverbalit e deri në Vendimin për Rrënim të Detyrueshëm nëse paraqitet nevoja.
- Kryen edhe punë të tjera nga fusha e ndërtimtarisë.
- Jep mendime profesionale për ndërtim, këshilla, sugjerime dhe udhëzime.

Objektivat e Inspektoratit Komunal të Ndërtimit për vitin 2026

-Parandalimi dhe monitorimi i objekteve pa leje ndërtimi.

-Kontrollimi dhe monitorimi i objekteve me leje ndërtimore deri në pajisjen me certifikatën e përdorimit.

-Kontrollimi i rrënimave të objekteve me leje dhe pa leje rrënimi.

-Shqyrtimi i parashtrësve.

-Bashkëpunimi me organe të tjera.

Realizimi i Objektivave

-Parandalimi dhe monitorimi i objekteve pa leje ndërtimi

- Aktiviteti dhe qëllimi i Inspektoratit të Ndërtimit është në identifikimin dhe parandalimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë së parë dhe të dytë.
- Inspektimet e kryera çdo herë konstatohen me procesverbal.

-Kontrollimi dhe monitorimi i objekteve me leje ndërtimore deri në pajisjen me certifikatën e përdorimit

- Ndërtimet me leje të kryhen sipas lejes së ndërtimit, projektit të aprovuar dhe pajisjes me certifikatën e përdorimit.
- Të jetë vendosur tabela informuese në punishte.
- Kontrollimi i dokumentacionit të nevojshëm në vendndërtim – lista e kontrollit.
- Udhëheqësi i vendndërtimit të jetë prezent në kohën e inspektimit.
- Gjatë inspektimit kontrollohet nëse ka tejkalime nga kushtet e lejes dhe merren të gjitha masat e parapara me ligj.
- Inspektimet e kryera konstatohen me procesverbal aty për aty.

-Kontrollimi i rrënimave të objekteve me leje dhe pa leje rrënimi

- Nëse rrënimi i objekteve bëhet me leje atëherë inspektorët bëjnë kontrollimin e rrënit, se a bëhet sipas lejes së lëshuar për rrënim.
- Nëse rrënimi bëhet pa leje, inspektorati ndërpret punimet dhe shqipton gjobë.

-Shqyrtimi i parashtrësve

- Shqyrtimi dhe vendosja në çështje bëhet nga inspektorët e ndërtimit sipas kompetencave ligjore.

-Bashkëpunimi me organe të tjera

- Kryerja e inspektimeve të përbashkëta me inspektorët tjerë të njësive tjera, sipas kërkesave të udhëheqësit dhe aksioneve të organizuara nga Sektori i Inspektimeve.

Plani vjetor i punës i Inspektoratit të Ndërtimit për vitin 2026

Janar 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar dhjetë (10) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Përgatitja e raportit për vitin 2025 2. Arkivimi i lëndëve dhe raportit 3. Shkarkimi i lëndëve 4. Vazhdimi i inspektimeve nga viti paraprak 5. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 6. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 7. Shqyrtimi i parashtrësve 8. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 9. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 10. Plani javor 11. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Shkurt 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar dhjetë (10) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtrësve 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Mars 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar katërmëdhjetë (14) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtrësve 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje

10. Raporti tremujor i punës (Janar - Mars 2026)	-Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Prill 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar pesëmbëdhjetë (15) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtresave 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Maj 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar pesëmbëdhjetë (15) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtresave 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Qershor 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar tetëmbëdhjetë (18) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtresave 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve

8. Plani javor 9. Raporti javor 10. Raporti tremujor i punës (Prill - Qershor 2026) 11. Raporti gjashtëmujor i punës (Janar - Qershor 2026)	-Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Korrik 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar tetëmbëdhjetë (18) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtrësave 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Gusht 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar tetëmbëdhjetë (18) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtrësave 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Shtator 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar tetëmbëdhjetë (18) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtrësave	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale

6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor 10. Raporti tremujor i punës (Korrik - Shtator 2026)	-Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Tetor 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar pesëmbëdhjetë (15) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtrësve 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim
Nëntor 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar pesëmbëdhjetë (15) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtrësve 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim

Dhjetor 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar dhjetë (10) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Vazhdimi i inspektimeve nga muaji paraprak 3. Inspektimi i objekteve me leje ndërtimi deri në pajisjen e certifikatës së përdorimit 4. Inspektimi i objekteve pa leje ndërtimi 5. Shqyrtimi i parashtresave 6. Inspektimi i rrëtimeve pa leje dhe me leje rrëtimi 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plan i javor 9. Raporti i javor 10. Raporti tremujor i punës (Tetor - Dhjetor 2026) 11. Raporti i punës për vitin 2026	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendim për ndërprerje të punimeve -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal -Vendim për rrënim

Gjatë këtij viti është planifikuar të zhvillohen 176 inspektime, të planifikuara, me parashtresë, të paplanifikuara dhe inspektime tjera.

Inspektorati Komunal i Shërbimeve Publike

Inspektorati komunal i Shërbimeve Publike vepron në bazë të autorizimeve dhe kompetencave ligjore nga Ligji Nr.04/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligji Nr.08/L-067 Për Inspektime; Ligji Nr.05/L-087 Për Kundërvajtje dhe Rregulloren 01.NR.114 Për Rregullin dhe Shërbimet Komunale në Komunën e Ferizajt dhe Statutin e Komunës së Ferizajt 01.Nr.50

Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit Komunal të Shërbimeve Publike, gjatë kontrollave inspektuese në teren

-Bën kërkesë për Miratimin e Inspektimit dhe bën njoftimin për Inspektim për palët që i nënshtrohen inspektimit.

-Inspektori Komunal i Shërbimeve Publike bën mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

-Kryen inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike (rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve shëtitoreve, sipërfaqeve të gjelbëruara dhe sipërfaqe tjera publike) nga dëmtimet, keqpërdorimet dhe shfrytëzimet e paautorizuara.

-Bën verifikimin e dokumenteve burimore, të cilat shfrytëzuesit e hapësirës publike duhet t'i posedojnë, sipas ligjeve përkatëse dhe rregulloreve komunale.

-Inspektimi i shesheve, parqeve, hapësirave të tjera të gjelbëruara, hapësirave reklamuese etj.

-Nxjerr vendime/urdhëresa lidhur me parregullsitë e paraqitura dhe ofron udhëzime juridike për palët.

-Ndërmerr masa ndëshkuese ndaj shkelësve të ligjeve përkatëse dhe rregulloreve komunale, harton kërkesat për fillim të procedurës ndaj kundërvajtësve dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave për të cilat është i autorizuar.

-Inspekton punimet e të gjithë operatorëve ekonomik në sipërfaqet publike.

-Të organizojë kontrollime të rastit.

-Kryen dhe detyra tjera të përcaktuara me ligj dhe akte tjera nënligjore.

Objektivat e Inspektoratit Komunal të Shërbimeve Publike për vitin 2026

-Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike.

-Inspektime për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe dëmtimin e pronës publike.

-Vendosja konform Ligjeve për mbishkrimet, panot, city lights dhe tabelat reklamuese, etj.

-Monitorimi i largimit të borës dhe akullit nga hapësirat publike.

-Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit.

-Shqyrtimi i parashtrësive.

-Bashkëpunimi me organe të tjera.

Realizimi i Objektivave

-Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike

- Aktiviteti i Inspektoratit të Shërbimeve Publike është identifikimi dhe ndalimi i shitësve ambulant, vendosjes së verandave, tavolinave, reklamave, çadrave, gjeneratorëve, vazove, materialit ndërtimor pa leje të organit kompetent.
- Inspektimet e kryera çdo herë konstatohen me procesverbal.

-Inspektime për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe dëmtimin e pronës publike

- Ndalimi i derdhjes së ujit të ujësjellësit në hapësira publike.
- Mirëmbajtja e shesheve.
- Mirëmbajtja e parqeve të qytetit.
- Mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve, shtigjeve të biçikletave, si dhe fushave sportive.
- Ndalohet gropimi, rrëmihja, prerja, ose shpuarja e hapësirave publike pa lejen e organit kompetent komunal.

-Vendosja konform Ligjeve për mbishkrimet, panot, city lights dhe tabelat reklamuese etj.

- Verifikimin e dokumenteve burimore, të cilat shfrytëzuesit e hapësirës publike duhet t'i posedojnë, sipas ligjeve përkatëse dhe rregulloreve komunale.

-Monitorimi i largimit të borës dhe akullit nga hapësirat publike

- Pastrimin e borës nga trotualet para ndërtesave afariste, qendrave tregtare, institucioneve, dhe shoqatave të cilat i kryejnë pronarët ose shfrytëzuesit e lokaleve.
- Gjatë pastrimit të trotuareve, nga pronarët dhe shfrytëzuesit e lokaleve, ndalohet hudhja e borës në sipërfaqe të rrugës; bora e pastruar duhet grumbullohet nëpër cepat e trotuareve ku nuk pengohet lëvizja.
- Monitorimi i kompanive të kontraktuara për largimin e borës nga rrugët.

-Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit

- Për tu kyçur në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe rrjetin e ujësjellësit subjektet dhe personat fizik duhet të pajisen me pëlqim nga kompanitë publike dhe leje nga organi kompetent komunal.
- Në rast se nuk veprohet sipas pikës së lartcekur Inspektorati Komunal i Shërbimeve Publike merr masa ligjore ndaj personave përgjegjës.

-Shqyrtimi i parashtresave

- Shqyrtimi dhe vendosja në çështje bëhet nga inspektorët e shërbimeve publike sipas kompetencave ligjore.

-Bashkëpunimi me organe të tjera

- Kryerja e inspektimeve të përbashkëta me inspektorët tjerë të njësive tjera, sipas kërkesave të udhëheqësit dhe aksioneve të organizuara nga Sektori i Inspektimeve.

Plani vjetor i punës i Inspektoratit Komunal të Shërbimeve Publike për vitin 2026

Janar 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar njëzet e pesë (25) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Përgatitja e raportit për vitin 2025 2. Arkivimi i lëndëve dhe raportit 3. Shkarkimi i lëndëve 4. Monitorimi për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora 5. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 6. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike. 7. Shqyrtimi i parashtresave 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal
Shkurt 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar njëzet e katër (24) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Monitorimi për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora 3. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 4. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike 5. Mirëmbajtja e hapësirave publike 6. Shqyrtimi i parashtresave 7. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 8. Plani javor 9. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal
Mars 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar tridhjetë (30) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent. 3. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmhjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal

6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtrësive 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor 11. Raporti tremujor i punës (Janar - Mars 2026)	
Prill 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar tridhjetë (30) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike (trotuareve) në vendndërtime 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtrësive 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal
Maj 2026 Gjatë këtij muaji janë planifikuar tridhjetë e gjashtë (36) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike (trotuareve) në vendndërtime 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtrësive 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal

Qershor 2026

Gjatë këtij muaji janë planifikuar katërdhjetë (40) inspektime

Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike (trotareve) në vendndërtime 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtresave 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor 11. Raporti tremujor i punës (Prill - Qershor 2026) 12. Raporti gjashtëmujor i punës (Janar - Qershor 2026)	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal

Korrik 2026

Gjatë këtij muaji janë planifikuar katërdhjetë (40) inspektime

Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtresave 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal

Gusht 2026

Gjatë këtij muaji janë planifikuar tridhjetë e gjashtë (36) inspektime

Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtrësve 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal

Shtator 2026

Gjatë këtij muaji janë planifikuar tridhjetë e katër (34) inspektime

Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtrësve 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor 11. Raporti tremujor i punës (Korrik - Shtator 2026).	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal

Tetor 2026

Gjatë këtij muaji janë planifikuar tridhjetë (30) inspektime

Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa

4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtrësive 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor	-Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal
---	---

Nëntor 2026

Gjatë këtij muaji janë planifikuar njëzet e gjashtë (26) inspektime

Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtrësive 8. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 9. Plani javor 10. Raporti javor	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal

Dhjetor 2026

Gjatë këtij muaji janë planifikuar njëzet e dy (22) inspektime

Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
1. Shkarkimi i lëndëve 2. Largimi i shitësve ambulant të cilët nuk kanë leje nga organi kompetent 3. Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike 4. Monitorimi i kyçjeve ilegale dhe dëmtimet eventuale në rrjetin e ujërave të zeza, ujërave atmosferike si dhe në rrjetin e ujësjellësit 5. Inspektimet për parandalimin e gropimit, rrëmihjes, prerjes, ose shpuarjeve në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent komunal 6. Mirëmbajtja e hapësirave publike 7. Shqyrtimi i parashtrësive	-Udhëzime -Vërejtje -Urdhëresa -Njoftime -Procesverbale -Vendime për gjobë -Kërkesë për Kundërvajtje -Kallëzim penal

8. Monitorimi për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora 9. Bashkëpunimi me inspektorë të tjerë 10. Plani javor 11. Raporti javor 12. Raporti tremujor i punës (Tetor - Dhjetor 2026) 13. Raporti i punës për vitin 2026	
--	--

Në total janë paraparë të realizohen 373 inspektime të planifikuara, aty për aty, dhe inspektime sipas parashtrësve të pranuar.

Inspektorati Komunal i Tregut

Inspektorati komunal i Tregut vepron në bazë të autorizimeve dhe kompetencave ligjore nga Ligji Nr.04/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligji Nr.08/L-067 Për Inspektime; Ligji Nr.05/L-087 Për Kundërvajtje; Ligji Nr.03/L-181 Për Inspektoratin e Tregut; Ligji Nr.04/L-186 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181; Ligji Nr.2004/18 Për Tregtinë e Brendshme; Ligji Nr.04/L-005 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2004/18 Për Tregtinë e Brendshme.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Komunal të Tregut gjatë kontrolleve inspektuese në teren

-Bën kërkesë për Miratimin e Inspektimit dhe bën njoftimin për Inspektim për palët që i nënshtrohen inspektimit.

-Inspektori Komunal i Tregut, bën mbikëqyrjen në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e tregut.

-Inspekton të gjitha bizneset se a janë të regjistruara dhe a posedojnë leje pune dhe jep vërejtje dhe afate deri në eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë punës inspektuese.

-Kontrollon dokumentet, dëshmitë dhe informatat sipas lëndës së mbikëqyrjes inspektuese si dhe kërkon nga subjektet ekonomike ose nga të punësuarit e tyre që të përgatisin kopjet dhe dokumentet e nevojshme.

-Kërkon nga subjekti i cili i nënshtrohet inspektimit ose të punësuarit e tij që t'i dorëzojnë të dhënat nga furnizuesit e tyre.

-Mbikëqyr aktivitetet e subjekteve ekonomike gjatë shitjes së produkteve ose ofrimit të shërbimeve.

Objektivat e Inspektoratit Komunal të Tregut për vitin 2026

-Luftimi i informalitetit

-Mbrojtja e Konsumatorit

-Siguria e produkteve në treg

-Shqyrtimi i parashtresave

-Bashkëpunimi me organe të tjera

Realizimi i Objektivave

-Luftimi i informalitetit

- Kontrollon nëse biznesi është i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit - ARBK.
- Kontrollimi i faturave të blerjes së mallrave.
- Kontrolli i lëshimit të kuponave fiskal nga subjekti afarist për konsumatorët.

-Mbrojtja e Konsumatorit

- Kontrollon vendosjen e çmimeve dhe përputhjen e tyre në raft dhe arkë.
- Kontrollon deklaracionet dhe etiketat e produkteve konform ligjeve në fuqi.
- Kontrollon vendosjen e flamujve të origjinës.
- Siguron zbatimin e garancionit për produktet të cilat posedojnë garancion.

-Siguria e produkteve në treg

- Kontrollimi i certifikatave të kualitetit.
- Mënyra e ekspozimit të produkteve.

-Shqyrtimi i parashtresave

- Shqyrtimi dhe vendosja në çështje bëhet nga inspektorët e tregut sipas kompetencave ligjore.

-Bashkëpunimi me organe të tjera

- Kryerja e inspektimeve të përbashkëta me inspektorët tjerë të njësive tjera, sipas kërkesave të udhëheqësit dhe aksioneve të organizuara nga Sektori i Inspektimeve.

Plani vjetor i punës i Inspektoratit Komunal të Tregut për vitin 2026

Janar 2026	
Gjatë këtij muaji janë planifikuar tridhjetë (30) inspektime	
Detyrat e Punës	Masat/Veprimet
